



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER
ZYRA VENDORE ARSIMORE FIER
GJIMNAZI “PERIKLI IKONOMI” FIER

Nr. _____ prot.

Fier, më..... 2021

**RREGULLORE
PËR ZBATIMIN E MASAVE KUNDËR COVID-19
GJATË PERIUDHËS PËRGATITORE
PËR VITIN SHKOLLOR 2021-2022**

(1-24 shtator 2021)

Në zbatim të udhëzimeve nga MASR në periudhën 1-24 shtator do të zhvillohet mësim i reduktuar për disa lëndë, me qëllim përforsimin apo përsëritjen e temave të caktuara para fillimit të vitit shkollor 2021-2022.

Pas 3 ditëve të para të këtij procesi përgatitor, drejtorja e shkollës, duke pasur parasysh shkallën e frekuentimit të mësimi përforsues, do të vendosë nëse do të vijojë mësimi me kapacitet të plotë me një turn, apo nëse klasat do të ndahen në grupe, si gjatë vitit të kaluar shkollor.

Për të rregulluar pranimin dhe qëndrimin e nxënësve në klasë gjatë kësaj periudhe, hartohet kjo rregullore e posaçme, e cila mbështetet kryesisht në:

- Udhëzuesin për fillimin e vitit shkollor 2020-2021, ASCAP, gusht 2020
- Udhëzuesin për përmirësimin e arritjeve të nxënësve në arsimin e mesëm të lartë, si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia covid-19, ASCAP, gusht 2021
- Udhëzimin e ISHP-së nr. 1092 prot., datë 27.8.2021, mbi kujdesin dhe masat anticovid në strukturat shkollore.

Mësimi planifikohet fillimisht me një turn, me klasat e plota, duke pasur parasysh se pkesëmarrja e nxënësve në këtë periudhë nuk është e detyrueshme, si edhe përvojën e krijuar nga periudha të ngjashme në dy vitet e kaluara shkollore.

Nëse numri i nxënësve në tri ditët e para të kësaj periudhe tejkalon kapacitetin e klasave, do të zbatohet skenari i ndarjes së klasave në grupe.

HYRJA DHE DALJA NGA SHKOLLA

1. Nxënësit paraqiten në shkollë duke respektuar me përpikmëri orarin e komunikuar nga mësuesi kujdestar i tyre.
2. Grafiku i hyrjes së nxënësve do të jetë:
8.15 – 8.20: Hyrja e klasave XII, duke filluar nga klasa A, me interval një minutë nga njëra tjetra.
8.20 – 8.25: Hyrja e klasave XI, duke filluar nga klasa A, me interval një minutë nga njëra tjetra.
8.25 – 8.30: Hyrja e klasave X, duke filluar nga klasa A, me interval një minutë nga njëra tjetra. Në tri ditët e para këto klasa do të qëndrojnë në oborrin e shkollës deri sa të përfundojë regjistrimi dhe ndarja e përkohshme e nxënësve në klasa.
3. Nxënësit hyjnë në shkollë, pasi janë vendosur në radhë një nga një, në shenjat dalluese në oborrin e shkollës, me largësi 1.5-2 metra. të përcaktuara nga drejtorja e shkollës.
4. Nxënësi që ka simptoma të ngjashme apo temperaturë përpara ardhjes në shkollë, njofton mësuesin kujdestar, i cili në bashkëpunim me mjekun e shkollës ose mjekun e familjes,verifikon nëse nxënësi është i sëmurë apo jo.

5. Justifikimi i mungesës bëhet vetëm nga mjeku i familjes. Nxënësi që ka simptoma të ngjashme apo temperaturë përpara ardhjes në shkollë, njofton mësuesin kujdestar.
6. Hyrja e nxënësve bëhet e shoqëruar për secilën klasë nga mësuesi i orës së parë ose nga një punonjës tjetër, i caktuar nga drejtori/nëndrejtori që përgjigjet për masat anticovid.
7. Nuk lejohet që nxënësit të dalin nga godina dhe të rikthehen përsëri në të, brenda ditës.
8. Dera e shkollës do të qëndrojë e mbyllur, ndërsa dritaret dhe dyert e klasave ku zhvillohet procesi mësimor, do të qëndrojnë të hapura për të krijuar ajrosjen e nevojshme brenda tyre.
9. Lejohet vetëm një hyrje dhe një dalje në ndërtesën e shkollës.
10. Dalja nga ambientet e shkollës do të bëhet sipas rregullave, duke ruajtur distancimin social dhe fizik si me lart (1,5 metra), nën mbikëqyrjen e mësuesit të orës së fundit të punonjësve të tjerë të shkollës.
11. Ndalohet përdorimi i celularit në mjedisin e shkollës.
12. Lejohet vetëm një hyrje dhe një dalje në ndërtesën e shkollës (ardhja dhe largimi).
13. Nxënësit që nuk zbatojnë këtë udhëzues, trajtohen me masë disiplinore nga Komisioni i Etikës dhe Sjelljes.

QËNDRIMI DHE MËSIMI NË KLASË

1. Gjatë kësaj periudhe do të shfrytëzohen klasat sipas planit të vendosjes të zbatuar në vitin shkollor 2020-2021.
2. Gjatë procesit mësimor, nxënësit qëndrojnë në klasë duke respektuar distancimin fizik me nxënësit e tjerë dhe me mësuesit, 1.5- 2 metra.
3. Brenda klasës, nxënësit qëndrojnë ulur nga një nxënës në bankë dhe bankat janë të paktën 1.5 metra larg njëra- tjetrës. Në klasat ku kjo nuk është e mundur, nxënësit do të ndahen në klasa të tjera.
4. Nxënësit duhet të mbajnë maskë në ambientet e brendshme dhe në të gjitha aktivitetet mësimore në ambientet e shkollës.
5. Nxënësit ndalohen të dalin nga klasa gjatë orëve të mësimit, përveç rasteve kur duhet të përdorin tualetet. Në këtë rast nxënësi duhet të shoqërohet nga përgjegjësi i katit, mësuesit e edukimit fizik.
6. Gjatë pushimeve 5-minutëshe midis orëve mësuesit e caktuar për katin (mësuesit e edukimit fizik) dhe sanitaret duhet të monitorojnë daljet e nxënësve në korridor.
7. Aktivitetet për disa klasa zhvillohen në ambient të hapur (oborrin e shkollës), duke respektuar largësinë dhe rregullat e mësipërme.
8. Nuk lejohet ushqimi në klasë dhe mjedise.
9. Nxënësit e të gjitha klasave nga X-XII do të hyjnë vetëm në klasën e përcaktuar për nxënësit e kësaj klase, do të përdorin vetëm tualetin në korridorin ku ndodhet klasa e tyre, pa u takuar asnjë moment me nxënës të klasave të tjera.
10. Rregullat për lëvizjen e nxënësve do të jenë të afishuara në ambientet e klasave.
11. Nuk lejohet qëndrimi në korridore.
12. Nxënësit ruajnë distancimin fizik 1.5-2 metër, kur lëvizin në korridore.

13. Komunikimi, në rast nevoje, i nxënësit me drejtuesit apo stafin mësimor do të kryhet nëpërmjet mësuesit përgjegjës të katit, duke respektuar distancimin fizik dhe rregullat e tjera të përcaktuara më lart.
14. Nuk do të përdoren sende personale të panevojshme për procesin mësimor.
15. Nuk do të kontaktohen personat që mund të jenë të pranishëm në mjediset e institucionit arsimor.

TË TJERËT

Mësuesit, drejtuesit, punonjësit e shërbimit psiko-social, sanitare dhe roja, si edhe prindërit dhe persona të tjerë që do të hyjnë në mjediset e shkollës duhet të zbatojnë detyrimisht rregullat e përcaktuara në Udhëzimin e ISHP-së nr. 1092 prot., datë 27.8.2021, mbi kujdesin dhe masat anticovid në strukturat shkollore.

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe zbatohet për periudhën 1-24 shtator 2021.

DREJTORI

Natasha Mino